



**ODA E AVOKATËVË TË
KOSOVESADVOKATSKA
KOMORA KOSOVAKOSOVO
BAR ASSOCIATION**

Republika e Kosovës / Republika Kosova	
ODA E AVOKATËVË TË KOSOVËS ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA	
VENDIMI ESHTË I FORMËS SË PRERË ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA	
Data	12.04. 2023 vit. god.
Dana	" Punëtori i autorizuar Orylašçeni radnik

V.KD.Nr.1369-1-10/23

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVË TË KOSOVËS

Kolegji Disiplinor i OAK-së në përbërje nga :Adnan Pacolli-Kryetar i Kolegjit, Arsim Bilalli anëtar dhe Fitim Shporta anëtar, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ma.sc Vjollca Ajeti Administratore në Zyrën Disiplinore në OAK, duke vendosur lidhur me propozimin disiplinor të ZPD-së të OAK-së, me nr. 1369-5/2021 të datës 12.09.2022, sipas kundër të paraqiturit Av. nga Prishtina, në bazë të nenit 8.14.5.8 dhe 19 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK, për shkeljet disiplinore nga nenin 118 par.3 të Statutit të OAK-së,të dt. 04.11.2017 e lidhur me nenet 24 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit dt:01.12.2012, konform nenin 51 par.1. nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Avokatinë - Ligji Nr.04/L-193, në seancën kryesore dëgjimore të mbajtur më 26.01.2023 dhe seancën e kshillimit dhe votimit të datës 07.02.2023, mori këtë:

VENDIM

I paraqituri Av. nga Prishtina, avokat i licencuar pranë OAK-së

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse i njëjti ka bërë shkelje disiplinore me marrjen në përfaqësim të palës prej datës 12.04.2021 deri në revokimin e autorizimit më datë 06.05.2021 pa u konsultuar me avokatët paraprak. I njëjti ka marrë në përfaqësim palën e cila nuk i ka përmbushur detyrimet ndaj avokatëve paraprak, ndaj ka bërë shkelje nga neni 118 paragrafi 1.3 i Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 52 pika 1 dhe 3 të KEPA-së.

Kolegji Disiplinor i OAK-së në pajtim me nenin 41, 42 par.1, 43 dhe 44 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së e lidhur me nenin 123 par. 2 dhe 3 të Stautit të OAK-së dhe nenit 52 pika 1 dhe 3 të KEPA-së Ligjit për Avokatinë - Ligji Nr.04/L-193, të paraqiturit av. , me seli në Prishtinë i shqipton masën disiplinore dënim me:

G J O B Ě

Në shumën prej **3,000.00** (tre mijë) euro konform nenit 51 par. 1 pika 1.2 të Ligjit për Avokatinë Obligohet i paraqituri Av. që në emër të paushallit të kësaj procedure të paguaj shumën prej 50.00 (pesëdhjetë) euro.

Pagesa e shumës e gjobës në të holla dhe në emër të paushallit duhet të paguhet në Buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij vendimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Me datën 12.09.2022, Zyra e Prokurorit Disiplinor të OAK-së kishte pranuar fletëparaqitjen disiplinore të datës 22.11.2021, të ushtruar nga ushtruesit e fletëparaqitjes dhe për zhvillimin e procedurës disiplinore me pretendimet se avokati ka bërë shkelje disiplinore ngase ka pranuar që t'i ofroj ndihmë juridike palës për të cilin ka qenë i detyruar të refuzojë sipas KEPA neni 52 pika 1.3.

Pas pranimit të fletëparaqitjes së theksuar më lartë Zyra e Prokurorit Disiplinor të njetën e ka shqyrtuar dhe ka gjetur se ekzistojne dyshimet se i paraqituri ka bërë shkelje të rënda të Stautit të OAK-së dhe të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatëve, andaj Prokurori Disiplinor i ka filluar hetimet dhe pas përfundimit të hetimeve ka përgaditur propozimin disiplinor të cilin ia ka dërguar Zyres Disiplinore të OAK-së për Komisionin Disiplinor të OAK-së me rekomandimin që ndaj av. të zhvillohet procedura disiplinore, dhe të njëjtit t'i shqiptohet masë disiplinore për shkelje të rëndë e detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 par. 1.3 të Statutit të OAK-së, e lidhur me nenin 52 pika 1 dhe 3 të KEAP-së.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës, konform 21 par.1, nën par.1.2, të Rregullores mbi Procedurën Disiplinore është përgjegjës për miratimin apo refuzimin e rekomandimit të zyres së Prokurorit Disiplinor të OAK-së lidhur me atë se a ekziston apo jo arsyeja e bazuar për shqyrtimin e çështjes.

Komisioni Disiplinor në seancën e mbajtur me shqyrtim fillestar e ka aprovuar propozimin disiplinor të ZPD-së me nr. 1369-5/21 të dt. 12.09.2022, duke gjetur se ekziston arsyeja e bazuar për shqyrtimin e çështjes dhe ka vendosur që të fillon Procedura Disiplinore pasi që ekzistojnë arsyet e bazuara për vazhdimin e procedurës disiplinore.

Komisioni Disiplinor i OAK-së mbajti seancën kryesore dëgjimore më dt. 31.10.2022 në prezencën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së — Rexhep Veseli I paraqituri Av. Kryetari i Kolegjit Adnan Pacolli si dhe Antarët e Kolegjit Arsim Bilalli dhe Fitim Shporta, me praninë e ushtruesve të fletëparaqitjes.

Kolegji Disiplinor i OAK-së bëri administrimin e provave, dëgjimin e Prokurorit Disiplinor të OAK-së me propozimin që i paraqitura av. të shpallet përgjegjës dhe të njejtit t'i shqiptohet masë disiplinore konform normativës së OAK-së,

Kolegji disiplinor konstaton gjendjen faktike me administrimin e provave që gjinden në shkresat e lëndës dhe atë :

- Fletëparaqitja e datës 22.11.2021 ;
- Parashtrësë drejtuar Gjykatës C.nr. 107/19 e datës 18.05.2021;
- Autorizimi i i datës 10.06.2014;
- Shkëputje e marrëveshjes, Revokim i autorizimit të datës 06.05.2021;
- Njoftim para Padisë i datës 23.06.2021;
- Procesverbali për pranimin — dorëzimin e lëndës të datës 17.05.2021 ;
- Parashtrësë e datës 23.07.2021 drejtuar av. ;
- Emaili i datës 08.05.2021 ;
- Procesverbal Gjykatës Themelore në Prishtinë i datës 16.06.2022;
- Autorizimi i i datës 12.04.2021;
- Njoftimi i datës 05.01.2022

Si dhe shkresat e tjera në dosjen e lëndës dhe konstaton se i paraqituri Av. ka bërë shkelje të rëndë e detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 par 1.3 të Statutit të OAK-së, e lidhur me nenin 52 pika 1 dhe 3 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Avokati ka bërë shkelje disiplinore ngase ka marrë në përfaqësim palën nga data 12.04.2021 e cila i kishte dhënë autorizim avokatëve tjerë nga data 10.06.2014 dhe këtë pa u konsultuar fare me avokatët paraprak.

Në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës është fakt i pakontestueshëm që av. të ketë kryer veprimin sipas fletëparaqitjes. Ndërsa sa i përket pretendimeve të të paraqiturit Av. se veprimet e tij nuk paraqesin shkelje të dispozitave nga KEPA, të njëjtat pretendime janë të pabazuara. I paraqituri Av. në deklarinë e tij nuk e ka mohuar që të ketë marrë palën në përfaqësim pa e njoftuar avokatët paraprak por që i njëjti është thirrur se nuk ka përfituar nga përfaqësimi i palës dhe se me marrëveshjen e arritur në seancën ku ka përfaqësuar është dakorduar që pagesa nga ana e të paditurës t'i bëhet direkt në xhirologarinë e palës . Ndërkaq në bazë të kësaj marrëveshje të arritur në Gjykatë, i paraqituri Av.

ka hequr dorë nga shpenzimet e procedurës kontestimore e të cilat veprime janë ndërmarrë nga ushtruesit e fletëparaqitjes.

Në seancën e datës 31.10.2022 i paraqituri Av. ka propozuar se në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohet . Kolegji disiplinor me Aktvendim ka obliguar të paraqiturin Av. që për seancën e datës 14.11.2022 t'a sigurojë praninë e dëshmitarit të propozuar.

Më datë 11.11.2022 i paraqituri Av. ka parashtruar kërkesë për përjashtimin e antarit të kolegjit disiplinor Av. Arsim Bilalli, kërkesë kjo e cila nuk i është dorëzuar me kohë nga administrata tek kolegji disiplinor të OAK-së për seancën e datës 14.11.2022 e që në mungesë kësaj kërkesë të paraqiturit Av. dhe dëshmitarit të propozuar nga i paraqituri, kolegji ka mbajtur seancën pa praninë e tyre.

Pas njoftimit nga administrata e OAK-së se i paraqituri ka paraqitur kërkesë për përjashtim të anëtarit të kolegjit disiplinor të OAK-së, procedura është rihapur dhe për kërkesën e tij është marrë aktvendim nga kryetari i komisionit disiplinor me V.KD.nr 1369-1-7/21 të datës 27.12.2022, ku është refuzuar kërkesa e të paraqiturit për përjashtimin e anëtarit të kolegjit Arsim Bilalli.

Pas kësaj kolegji disiplinor ka caktuar seancën e radhës më datë 26.01.2023 për të cilën seancë i paraqituri është ftuar në mënyrë të rregullt por që i njëjti nuk ka marrë pjesë në seancë me çka ka kërkuar nga komisioni që seanca të shtyhet për një ditë tjetër, me arsyetimin që i njëjti ka seancë gjyqësore të caktuar në çështje penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

I paraqituri Av. _____ ftesën për seancën e datës 26.01.2023 ne komision disiplinor e ka pranuar më datë 18.01.2023 ndërsa ftesën për gjykatë e ka pranuar me vonë dhe i njëjti ka pasur mundësi të dërgojë një zëvendësues në seancë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, meqë seanca në komision disiplinor është caktuar më heret dhe duke pas parasysh që një seance për arsye të njejte është shtyer me kërkesë të të paraqiturit.

I paraqituri edhe me pare ka bërë kërkesë për shtyrje të seancës të dt.07.10.2022 të cilën kërkesë kolegji ja ka aprovuar dhe e ka shty atë seance për një datë tjetër. Kolegji disiplinor ka konsideruar që kërkesa e fundit për shtyrje të seancës ka për qëllim vetëm zvarritjen dhe prolongimin e kësaj procedure ndaj dhe ka vendosur si ne aktvendimin e dt.26.01.2023.

Në seancen e fundit është propozuar dhe aprovuar që të administrohet si provë Urdhër Pagesa me numër 2022-195986, me të cilin dëshmohet se është kryer pagesa nga Ministria e Financave përkatësisht nga Thesari tek pala _____, sipas marrveshjes të cilën e kishin arritur në gjykatë të përfaqësuar nga paraqituri. Transaksioni bankar është i dt.15.08.2022. I paraqituri në seancën e dt.31.10.2022 para kolegjit disiplinor ka deklaruar që në momentin që do të ekzekutohen mjetet nga thesari pala e tij do ti kryej obligimet ndaj ushtrusve të fletëparaqitjes. Me provat e administruara dhe me ndëgjimin e ushtrusve të fletëparaqitjes vërtetohet se një gjë e tillë nuk ka ndodh.

Kodi i Etikës Profesionale të Avokatit e obligon avokatin që punën vet t'a kryejë me profesionalizëm dhe ndërgjegje. Avokati duhet t'i mbrojë interesat e klientit të vetë vetëm me mjete që janë në përputhje me ligjin dhe dinjitetin e profesionit të avokatit. Të gjitha këto janë rregulla të mirësjelljes së avokatit, të sanksionuara me Statutin e OAK-së dhe Kodin e Etikës Profesionale të Avokatit. Në këtë mënyrë, Avokati _____ bëri shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 par. 1.3 të Statutit të OAK-së, e lidhur me nenin 52 pika 1 dhe 3 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Kolegji disiplinor, duke u mbështetur në të gjitha provat e administruara, vërtetohet gjendjen faktike dhe këtë bazë në përputhje me normativen e OAK-së merr vendimin për përgjegjësinë disiplinore të avokatit të paraqitur dhe t'ia shqiptojë masën disiplinore, sipas shkallës së përgjegjësisë së tij. Duke u bazuar në arsyet e theksuara më lartë Kolegji Disiplinor i shqyrtimit gjeti se av.


nga Prishtina është përgjegjëse për shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 par 1.3 të Statutit të OAK-së, e lidhur me nenin 52 pika 1.3 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, andaj vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Nga një kopje me shkrim të këtij vendimi u dërgohen:

- Ushtruesit të fletëparaqitjes
- Të paraqiturit
- Zyrës së Prokurorit Disiplinor
- Kryesuesit të Kolegjit Disiplinor
- Kryetarit të Komisionit Disiplinor të OAK-së.

Kolegji Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD.Nr.1369-1-10/2, dt: 07.02.2023

Procesëmbajtësja:
Ma.sc.Vjollca **Ajeti**



Kryesuesi i Kolegjit Disiplinor:
Adnan Pacolli



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 8 ditësh pranë Komisionit të Ankesave të OAK-së përmes këtij Komisioni.